

KONTRATA SOCIALE SHKODËR

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESË



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:
Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorës,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Ky Raport nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi e vëtëm autorëve, Organizatës “Intelektualët e Rinj Shpresë”





Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	4
FALENDERIME	5
HYRJE.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE.....	10
INFORMACION I PËRGJITHSHËM – KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR.....	11
MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK PAS KONSTITUIMIT TË TIJ.....	12
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE:.....	14
REKOMANDIME	27



Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID 19	Pandemia e Virisit Korona
Kontrata Sociale	Prioritetet kryesore të identifikuara nga të rinjtë gjatë 2019



Falenderime

Për të hartuar këtë raport bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Shkodër, dhe drejtoritë përkatëse për përgjigjet e shpejta brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Shkodër, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë kësaj periudhe një vjeccare. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.



Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura. Bashkia Shkodër nuk e ka nënshkruar si dokument por është njohur me të.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me "Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal." Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llobojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të kontratës sociale për periudhën gusht 2019 – gusht 2020.

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkia dhe të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Qendra për Progres Rinor, për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë muajve gusht 2019 - gusht 2020 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioritetëve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;

- Të llojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Gjatë muajve Mars – Qershor 2020 fokus të vecantë iu kushtua menaxhimit të situatës Covid 19, vendimarrjes së këshillit Bashkiak dhe menaxhimit të pandemisë nga Bashkia Shkodër¹.

Përmbledhje Ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Shkodër, të kryer nga Intelktualët e Rinj Shpresë, më poshtë disa nga gjetjet.

- Në lidhje me prioritetet e kontratës sociale rezulton se janë bërë disa hapa pozitive nga ana e Bashkisë Shkodër në disa fusha.
- Në lidhje me problematiken e shfaqur nga shumica e fermerëve për pajisjen me certifikatën e pronësisë mbi tokën. Keshilli i Bashkisë Shkodër ka miratuar aktet e nevojshme për miratimin e AMTP-ve (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi), për personat që kanë përfituar me ligjin 7501, datë 19.07 1991. Ky proces pritet t'i japë fund procesit të regjistrimit fillestar të tokave. Ky proces do të realizohet gjithashtu edhe për pronat shtetërore në administrim të Bashkisë Shkodër.
- Procesi i konsultimit për miratimin e planit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021- 2023 për shkak të pandemisë Covid 19 u pezullua për shkak të pamundësisë për të realizuar degjese publike me numër të lartë të banorëve. Në këto kushte në Bashkinë Shkodër marrja e mendimit të qytetarëve në lidhje me procesin e konsultimit të draftit të Projektplanit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021- 2023 po një ankete e cila aksesohet online. Në këtë mënyrë qytetarët mund të shprehin mendimet e tyre deri me datën 5 tetor 2020.

¹ <https://popnetwork.al/en/raporti-i-monitorimit-bashkia-shkoder-2/>

- 250 qytetarë kanë aplikuar për banesa sociale në Bashkinë Shkodër. Nevojat janë të medha dhe parashikohet të shperndahen edhe 100 kredi të buta për të ndihmuar qytetaret në lidhje me strehimin social.² Programi i strehimit social në Bashkinë Shkodër kishte vite që ishte pezulluar, kështu miratimi i akteve ligjore dhe nenligjore si dhe akteve të Keshillit Bashkiak mundësuan rihapjen e aplikimeve për disa programe të strehimit social si: Programi i banesave sociale dhe bonusi i qirasë.
- Minoriteti rom do të jetë përfitues i 27 banesave sociale që po ndërtohen dhe pritet të jenë të gatshme deri në fund të vitit 2020.
- Ndërtimi i fushave sportive të shkollës “Gjergj Vat Martini”, Njesia Administrative Velipojë është një investim i Bashkisë Shkodër që plotëson një nga kërkesat e të rinjve të kesaj sone.
- Këshilli Bashkiak që nga konstituimi i tij ka vazhduar punën normalisht duke u mbledhur të paktën një herë në muaj ose më shumë në varësi të nevojave. Për periudhën Mars-Maj që është edhe periudha e kufizimeve të levizjes për shkak të pandemisë botërore Covid 19 Këshilli Bashkiak i ka realizuar mbledhjet në distancë nëpërmjet programeve të internetit, pra nepermjet takimeve online. Diskutimet e Keshillit janë publikuar në rrjetin social facebook të Keshillit Bashkiak.³
- Sipas nenit 27 të Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e Keshillit Bashkiak Shkodër: “Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së keshillit për këshilltarët bëhet si rregull jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Në mungesë të sekretarit njoftimi bëhet nga një punonjës i bashkisë i caktuar nga kryetari i keshillit. Kur në rend të ditës janë çështje të tilla si buxheti apo paketa fiskale, njoftimi për këshilltarët duhet të bëhet jo më pak se 10 ditë para datës së mbledhjes.” Kjo dispozite nuk zbatohet në të gjitha rastet nga Keshilli Bashkiak Shkodër.
- Këshilli Bashkiak ka miratuar akte të rëndësishme vendim nr.19 date 23.04.2020 për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2019 të Bashkisë

² https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=710467076177360&id=231773114046761

³ <https://www.facebook.com/Keshilli-Bashkiak-Shkoder-110426817043979/>

Shkodër dhe vendim nr.26 date 30.12.2019 për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë së Shkodrës si dhe paketën fiskale të 2020.

- Paketa Fiskale e 2020 për Bashkinë Shkodër konsiderohet si një paketë fiskale sociale duke qënë se parashikon lehtësimin nga tarifat të shtresave në nevojë apo rritjen e shtrëngimeve ndaj atyre që ndosin, bllokojnë etj. Ndër parashikimet kryesore janë
- 0 tarifë në sistemin arsimor parashkollor për fëmijët e familjeve me prind PAK, familje me Ndhmë Ekonomike apo për fëmijët e k/familjareve të veja apo nënave me urdhër mbrojtje.
- Kush ndot më shumë, paguan më shumë: diferencohet taksa e pastrimit sipas llojit të biznesit.
- Diferencim i tarifës së ndriçimit sipas dendësisë së popullsisë dhe fluksit të vizitorëve.
- Akses në qytet për personat me AK: gjobë për bllokim të rampave të trotuareve apo të vendparkimeve të dedikuara për këtë grup (Të ardhurat nga këto zëra shkojnë në mbështetje direkte të kësaj kategorie në nevojë)
- Tarifim maksimal për zënien e hapsirës publike.
- Akses i shtuar për studentët, fillon implementimin Karta e Studentit
- Bashkia Shkodër ka vijuar shpenzimet në bazë të buxhetit për vitin 2020, në faqën zyrtare të Bashkisë Shkodër në transparencën e buxhetit rezulton se 43% është përqindja e Realizimi të Buxhetit të vitin 2020, Kjo llogaritje është për 7 mujorin e parë të 2020.
- Në kuadër të pandemisë Covid 19 Bashkia Shkodër ka marrë masat e saj të cilat janë pasqyruar edhe në publikimin “Monitorimi i Bashkisë Shkodër në lidhje me masat e ndërmarra në kuadër të pandemisë” ⁴

⁴ http://irsh.al/ep-content/uploads/2020/05/Raporti_Bashkia-Shkoder_COVID-19.pdf

Procesi i formulimit të prioriteteve të kontratës sociale

Për identifikimin e prioriteteve të komunitetit për Bashkinë Shkodër në mars 2019 u zhvilluan 6 Forume me banorë të rajoneve të qytetit të Shkodrës, Bërdicës, Gurit të Zi, Dajçit dhe Postribës. Në Forume u diskutuan 22 çështje me interes për komunitetet lokale, si dhe u identifikuan prioritetet në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej Forumeve u përfshinë qytetarë të grupmoshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Publikimi i prioriteteve të kontratës sociale

Çështjet e diskutuara në forumet civile janë përfshirë në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

1. Zhvillimi ekonomik vendor
2. Shërbimet publike
3. Dimensioni social
4. Demokracia vendore

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. Ndërhyrje prioritare, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. Ndërhyrje disi prioritare, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;
3. U formuluan dhe listuan sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti, 26 prioritetet.

Lobimi dhe monitorimi i vazhdueshëm

Gjatë vitit 2020 është vijuar me "Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal." POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër,

Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Shoqata "Intelektualët e rinj, Shprese" në bashkëpunim me komunitetin ka monitoruar pushtetin lokal në lidhje me prioritetet e formuluar në Kontratën Sociale 2019 për Bashkinë Shkodër.

Informacion i përgjithshëm – Këshilli Bashkiak Shkodër

Struktura

Këshilltarë 51

Raporti gjinor: 25 Femra , 26 meshkuj, ne perqindje 49% femra dhe 51% meshkuj.

Kryetar i Këshillit Bashkiak Znj. Brisela Kadija

Zv/ Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Arvit Osja

Zv/ Kryetare e Këshillit Bashkiak Znj. Tereze Brigja

Zv/ Kryetare e Këshillit Bashkiak Znj. Suada Selimaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak Z. Denis Lesh

Raporti gjinor është ruajtur edhe në strukturat drejtuese të Këshillit Bashkiak ku siç verëhet Kryetari i Këshillit është grua dhe zëvendës kryetar janë një burrë dhe dy gra. Sekretar një burrë. Raporti në total 3 gra dhe 2 burra.

Komisionet e Këshillit Bashkiak Shkodër

Në total janë krijuar 17 Komisione.

- 1 Komisioni i financave, buxhetit, dhe aseteve publike
- 2 Komisioni i kontrollit financiar
- 3 Komisioni i Shërbimeve publike
- 4 Komisioni i planifikimit dhe zhvillimit të territorit
- 5 Komisioni i zhvillimit ekonomik dhe turizmit
- 6 Komisioni i shëndetësisë, veterinarisë dhe mbrojtjes së konsumatorit
- 7 Komisioni i shërbimeve sociale, strehimit dhe çështjeve gjinore
- 8 Komisioni i bujqësisë, pyjeve, dhe menaxhimit të ujërave dhe mbrojtjes së mjedisit
- 9 Komisioni i Arsimit

- 10 Komisioni i kultures dhe i trashëgimise
- 11 Komisioni i Rinise dhe Sportit
- 12 Komisioni për çështjet ligjore
- 13 Komisioni i vlersimit të figurave të shquara dhe emertesave
- 14 Komisioni i mandateve dhe rregullores
- 15 Komisioni i marrëdhënieve me jashtë
- 16 Komisioni i rendit publik dhe mbrojtjes civile
- 17 Komisioni i barazise gjinore

Nga 17 Komisione që ka Këshilli i Bashkisë Shkodër ato të cilat përbëjnë interes për POP dhe prioritetet e dala nga komuniteti janë vijueset:

Komisioni i Rinise dhe Sportit

Komisioni i Arsimit

Komisioni i bujqësisë, pyjeve, dhe menaxhimit të ujërave dhe mbrojtjes së mjedisit

Komisioni i shërbimeve sociale, strehimit dhe çështjeve gjinore.

Komisioni i zhvillimit ekonomik dhe turizmit

Komisioni i shëndetësisë, veterinarisë dhe mbrojtjes së konsumatorit

Komisioni për planifikim dhe zhvillimit të territorit

Komisioni i Shërbimeve Publike

Komisioni i barazise gjinore

Monitorimi i Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pas konstituimit të tij.

Mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak, është zhvilluar duke u bazuar në nenin 48, pika 1, të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjes vendore". *"Këshilli Bashkiak e zhvillon mbledhjen e tij të parë, jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve."*

Ndërsa pika 2 e nenit 48 e ligjit Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjes vendore" përcakton: *"Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti."*

12

Në mungesë të sekretarit të këshillit dhe në situatën e tensionit politik të krijuar ishte Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr.961, datë 16.08.2019, që njoftoj thirrjen e mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak. Mbledhja u zhvillua me datë 19.08.2019. Kjo mbledhje nuk u zhvillua në ambjente të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Shkodër për arsye të tensionit politik të krijuar. Kjo mbledhje u zhvillua në ambjentet e Rektoratit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

Vendimet që u morën ishin:

- Vendim Nr.: 1 Dt.: 19.08.2019, për ngritjen e komisionit të mandateve.
- Vendim Nr.: 2 Dt.: 19.08.2019, për vertetimin e mandateve të anetareve të këshillit bashkiak Shkoder
- Vendim Nr.: 3 Dt.: 19.08.2019, për emerimin e kryetarit të këshillit bashkiak Shkoder
- Vendim Nr.: 4 Dt.: 19.08.2019, Për zgjedhjen e zv.kryetareve të këshillit bashkiak Shkoder

Gjatë periudhës Shtator 2019-Gusht2020 Këshilli bashkiak është mbledhur rregullisht. Përgjatë periudhës së kufizimeve të lëvizjeve për shkak të masave për mbrojtjen nga Covid 19 mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë zhvilluar online nepermjet aplikacioneve me lidhje me internet.

Njoftimi i ditës, orës dhe vendit të mbledhjes së radhës së këshillit bashkiak, së bashku me rendin e ditës bëhet rregullisht në faqën e internetit të Bashkisë Shkodër si dhe në rrjete sociale. Gjithashtu mbledhjet e këshillit bashkiak transmetohen direkt në median lokale.

Sipas nenit 27 të Rregullores Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Bashkiak Shkodër:
“Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së këshillit për këshilltarët bëhet si rregull jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Në mungesë të sekretarit njoftimi bëhet nga një punonjës i bashkisë i caktuar nga kryetari i këshillit. Kur në rend të ditës janë çështje të tilla si buxheti apo paketa fiskale, njoftimi për këshilltarët duhet të bëhet jo më pak se 10 ditë para datës së mbledhjes.” Kjo dispozite nuk zbatohet në të gjitha rastet nga Këshilli Bashkiak Shkodër.

Sic është rasti i Njoftimit të mbledhjes nr 6 së Këshillit Bashkiak, ku sipas shkreses nr. prot 6959, që mban datën 20.05.2020, mbledhja është thirrur për dy ditë më vonë pra në datë 22.05.2020.

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale:

Nga komunikimet zyrtare dhe monitorimi i dokumentave zyrtare rezulton:

Në lidhje me prioritetin 3 “Zhvillimi i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të certifikimit të pronësisë mbi token”.

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të Bashkisë Shkodër. Numri i fermave bujqësore është rreth 11200 dhe me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe fruti kulturë (për tregun lokal), me njëmadhësi mesatare prej 1.1 Ha/fermë e ndarë kjo në 2-3 parcela. 48% e popullsisë së Bashkisë Shkodër banon në zonat Rurale.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të veta”, të tilla si: Administrimin e sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP

a) Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe në pronësi private, si dhe të kategorive të resurseve të tjera, të përcaktuara në nenin 11 të ligjit 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, për të gjithë territorin në juridiksion të komunës dhe/ose bashkisë.

b) Mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues në ish komunat, njësi administrative të reja të bashkisë, që ka për objekt kategoritë e resurseve në juridiksion të saj.

c) Përgjigjet për grumbullimin dhe sistemin e dokumentacionit të ri kadastral për tokën bujqësore dhe të kategorive të resurseve të tjera që me ligj janë transferuar në përdorim/pronësi të bashkisë, sipas burimeve të informacionit të përcaktuara në pikat 5, 6, dhe 7, të kreut III të këtij vendimi.

d) Bazuar në dokumentacionin kadastral ekzistues dhe dokumentacionin e ri kadastral, që grumbullohet dhe sistemohet, plotëson “Regjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve”, të miratuar me urdhrin e përbashkët, nr.107, datë 27.3.2009 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm.

Meqenese bashkia Shkoder dhe konkretisht, kesaj drejtorie i lind nevoja per plotesimin e kesaj kadastre me materialet perkatese.

Keshtu për të përfunduar procesin e regjistrimit në kadastër të titujve të pronësisë (AMTP) të përfituar më ligjin 7501, date 19.07 1991, këshilli bashkiak gjatë muajit Dhjetor dhe Janar miratoj vendime për lehtësimin e këtij procesi.

Kështu u miratuan këto projekt vendime:

Vendim nr 28 date 30.12.2019 “Miratimin e listes se perdoruesve faktike, subjekteve perfituese dhe siperfaqes te tokes bujqesore qe plotesojne kushtet ligjore per tu pajisur me amtp, ne fshatin Bardhaj dhe Shtoj i vjter, njesia administrative Rrethinat, Bashkia Shkoder”

Vendim nr 1 date 22.1.2020 “Per miratimin ne parim te ngritjes se komisionit te perkohshme (ad-hoc) per verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjore te procesit te AMTP”

Në lidhje me Prioritetin 15. Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme.

Në Bashkinë Shkodër për marrjen e mendimit të qytetarëve në lidhje me procesin e konsultimit të draftit të Projektplanit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021- 2023 të Bashkisë Shkodër, në pamundësi të organizimit të degjesave publike me pjesëmarrje të gjërë për shkak të Covid 19, është përdorur si metodologji, marrja e mendimeve nepermjet një ankete e cila aksesohet online. Në këtë mënyre qytetarët mund të shprehin mendimet e tyre deri me datën 5 tetor 2020.⁵ Qëllimi i kësaj nisme është miratimi i një buxheti gjithëpërfshirës, konkret dhe të matshëm. Gjithashtu për çdo ide apo sugjerim qytetarët mund të shkruajnë në emailin e këshillit: keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al.

⁵Njoftim_per_keshillim_me_publikun_Per_draftin_e_Projektplanit_Buxhetor_Afatmesem_2021_2023_te_Bashkis_e_Shkoder_1683_1



Fig.1. Njoftimi për të marrë komentet e qytetarëve për PBA 2021-2023, marre nga faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër.⁶

⁶Shiko në linkun më poshtë:

<https://www.facebook.com/bashkiashkodres/photos/a.426398424132697/3005515556220958/>

Këshilli Bashkiak Shkodër, në muajin dhjetor 2019 nëpërmjet konsultave të komisioneve përkatëse me administratën e Bashkisë, mundi të materializojë një sërë ndërhyrjesh dhe përmirësimesh në parashikimet e Buxhetit të vitit 2020. Kjo qasje proaktive do të vazhdojë përgjatë gjithë këtij vit nëpërmjet monitorimeve të ndryshme nga ana e Keshillit Bashkiak nepermjet komisioneve të ndryshme për këto çeshtje:

- Planin e Mobilitetit
- Planin&Implementimin e Investimeve
- Shërbimin e Transportit Urban
- Shërbimin e Strehimit Social
- Vllaznia sh.a.

Në këtë mënyre verehet një rritje e vemendjes ndaj një nga prioriteteve kryesore të shprehura nga qytetaret në kontratën sociale, pikërisht, prioriteti nr. 5 *“Organizimi i shërbimit të transportit në përputhje me nevojat e komuniteteve të njësive administrative”*.

Në lidhje me dimensionin social janë bërë ndërhyrje të rëndësishme nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Këshillit Bashkiak.

Bashkia Shkodër nuk ka aplikuar programe të strehimit social për kategoritë të personave në nevojë. Procesi i aplikimit për programe strehimi ka qene i pezulluar për shkak të mungesës së akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për strehimin social. Në këtë drejtim janë ndërmarrë hapa cilësor për zhvillimin e programeve të strehimit social.

Kështu, nga ana e Bashkisë Shkodër vazhdon investimi për ndërtimin e banesave sociale. Aktualisht po punohet për zbatimin e projektit më të ri të ndërtimit të banesave sociale në Bashkinë e Shkodrës. Minoriteti rom do të jetë përfitues i 27 apartamenteve që po ndërtohen dhe pritët të jenë të gatshme deri ne fund të vitit 2020.Në projekt është parashikuar që të ndërtohen edhe ambjente rekreacionale e të kalimit të kohës së lirë për famijet. Po ashtu ka përfundur ndertimi i banesave sociale në ish konviktin e shkollës pyjore.

Po në këtë linjë Keshilli Bashkiak ka miratuar vendimet që do të sigurojne zbatimin e programeve të strehimit social nga Bashkia shkodër si më poshtë:

- Vendim, nr 2 date 22.1.2020 "Per miratimin e ngritjes,perberjes dhe funksionimit te komisionit te strehimit"
- Vendim, nr 3 date 22.1.2020 "Për miratimin e sistemeve te pikezimit per programet sociale te strehimit per vitin 2020"
- Vendim, nr 4 date 22.1.2020 "Per miratimin e formularit te kerkeses per te perfutuar nga programet e strehimit social".
- Vendim i Keshillit Bashkiak Shkoder nr.12 date 26.02.2020 "Për miratimin në parim të bashkëfinancimit për përshtatjen për strehim social të objekteve ekzistuese në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit për vitin 2020"



Fig. 2 & 3. Monitorimi i investimit për ndërtimin e banesave sociale për Komunitetin Rom & Egjiptian⁷

Bashkia Shkodër ka hapur aplikimet për strehim social në bazë të vendimeve të këshillit bashkiak. Njoftimi është bërë në rrjetin social facebook të Bashkisë Shkodër dhe në mediat lokale.⁸

250 qytetarë kanë aplikuar për banesa sociale në Bashkinë Shkodër. Nevojat janë të medha dhe parashikohet të shperndahen edhe 100 kredi të buta për të ndihmuar qytetaret në lidhje me strehimin social.⁹

⁷ <https://www.facebook.com/370972339675306/posts/2839744762798039/>

⁸ <https://www.facebook.com/370972339675306/posts/2715019558603894/>

Përshtatshmëria e infrastrukturës së qytetit në kuadër të rritjes së aksesueshmërisë për personat me aftësi ndryshe është një tjetër investim i kryer nga Bashkia Shkodër. Disa nga rrugët kryesore të qytetit janë përshtatur në mënyrë që të lehtësojnë levizjen për personat me aftësi ndryshe. Kjo ka qënë një kërkesë e vazhdueshme e personave me aftësi ndryshe.



Fig. 4 & 5. Përshtatshmëria e infrastrukturës së qytetit të Shkodrës për PAK.

Në lidhje me prioritetin nr 6: **“Mirëmbajtja e shkollave ekzistuese dhe plotësimi me mjete didaktike.”** Nga informacioni i marrë nga Bashkia Shkodër rezulton se: Edhe në kuadër të fillimit të procesit mësimor në kushtet e reja për shkak të Covid 19 Bashkia e Shkodrës ka marrë masa për një fillim normal të vitit të ri shkollor në shkollat në territorin e saj. Mirëmbajtja e shkollave është në zbatim të kontratës me afat 3 muaj dhe deri në përfundimin e kontratës të gjitha objektet do të kenë punimet e realizuara.

Në punimet e mirëmbajtjes të objekteve arsimore, do të ndërhyhet për realizimin e punimeve në:

- 12 shkolla 9- vjeçare në njësitë administrative dhe në 10 shkolla 9-vjeçare në qytet,
- 4 shkolla të mesme, 2 në qytet dhe 2 shkolla në Njësi Administrative.
- Në zbatimin e punimeve për rrethimet e objekteve arsimore do të realizohen në:

⁹ https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=710467076177360&id=231773114046761

- 10 shkolla 9- vjeçare në qytet dhe në 5 shkolla 9-vjeçare në Njësi Administrative.
- Në kuadër të marrëveshjes mes Bashkisë Shkodër dhe shoqatës është bërë e mundur hapja e puseve për furnizim me ujë në 12 shkolla 9– vjeçare në njësitë administrative dhe 45 shkolla të mesme në njësitë administrative.
- Janë duke u furnizuar me materiale pastrimi të gjitha shkollat sipas grafikut të shpërndarjes..
- Ka përfunduar dezinfektimi dhe deratifikimi i ambjenteve të shkollave, proces i realizuar dy herë deri tani si pasojë e situatës së krijuar nga Covid -19.
- Në 2 shkolla në NjA janë duke u realizuar ndërhyrje për rikonstruksionin dhe përmirësimin e ambjenteve dhe infrastrukturës.
- Punimet për ndërtimin e fushave sportive të shkollës “Gjergj Vat Martini”, NjA Velipojë.
- Janë në proces lidhje kontrate për zbatimin e punimeve për rikonstruksionin e fasadës së shkollës “Seit Tagani”, Njësia Administrative Berdicë.
- Në ditët në vijim, do të kryhet bojatisja e 3000 m2 fasadë e jashtme e objekteve shkollore.
- Përveç punimeve të listuara mësipër përmes subjekteve të kontraktuara, gjithashtu, është duke u punuar në të gjitha shkollat edhe për ndërhyrjet bazike, punë që po kryhet nga grupi i punëtorëve të Bashkisë për sistemimin e ambjenteve të brendshme (lyerje e ambjenteve të brendshme, sistemim e rrjetit elektrik dhe atij hidraulik) dhe të jashtme (pastrimi dhe heqja e barërave), si dhe riparimin e mobiljeve (karriga dhe banka).
- Është në proces lidhja e kontratës për zbatimin e punimeve për rikonstruksionin e shkollës së mesme “Mehmet Shpendi”, Njësia Administrative Shalë.
- Janë drejt përfundimit punimet për rikonstruksionin e shkollës së mesme “Jordan Misja”, ku përfshihet përmirësimi i ambjenteve dhe infrastrukturës. Jemi brenda afteve dhe objekti do të jetë gati për fillimin e vitit të ri shkolle.
- Këtë shtator, përfundon faza e parë e rikonstruksionit. Klasat, ambjentet e shërbimit, sistemi elektrik, ngrohja qendrore, ndriçimi dhe pastërtia, do të ofrojnë mikpritjen për nxënës e mësues, por edhe prindërit.



Fig. 6 & 7. Pamje nga punimet për rikonstruksionin e shkollës së mesme “Jordan Misja”.¹⁰

Një nga kërkesat e vazhdueshme të rinjve është **ndërtimi i fushave sportive** apo kendeve sportive, sidomos në njesitë administrative, në të cilat aktivitetet kulturore dhe sportive thuajse mungojnë. Ndërtimi i fushave sportive të shkollës “Gjergj Vat Martini”, Njesia Administrative Velipojë është një investim i Bashkisë Shkoder që plotëson një nga kërkesat e të rinjve të kësaj sone.




Fig. 8 & 9. Punimet për ndërtimin e fushave sportive të shkollës “Gjergj Vat Martini”, NJA Velipojë.

¹⁰ <https://www.facebook.com/370972339675306/posts/2896711820434666/>

Në Bashkinë Shkodër ka hapur dyert kopshti më i ri emërtuar “Njomëzat”. Ky kopsht ofron shërbimet e tij për familjet në lagjet numër 5 dhe 3 të qytetit. Kopshti do të ofrojë edukimin, mësimdhënien, shërbimin e ushqimit, fjetjen, argëtimin në një kënd lojrash në territorin e tij. Gjithashtu pjesë e “Njomëzave” është edhe çerdhja e re që do të hapët gjithashtu në këtë fillim të vitit shkollor duke ofruar shërbime për fëmijët 0-3 vjeç. Në kushtet e veçanta që ka nisur ky vit edhe për parashkollorët, një vëmendje e shtuar u kushtohet masave antiCovid, duke i zbatuar rigorozisht.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës kanë nisur vitin parashkollor në 57 kopshte e çerdhe mbi 2 mijë fëmijë. Ofrimi i këtij shërbimi, është një nga prioritetet e qëndrueshme të Bashkisë së Shkodrës, ndihmesë konkrete për familjet shkodrane në lehtësimin e përditshmërisë së tyre, sidomos për ata që janë në marrëdhënie pune. Ky investim lidhet **me prioritetin nr 25 “Rikonstruksion i kopshteve dhe çerdheve egzistuese në qytetin e Shkodrës, sipas nevojave të identifikuar, dhe i kopshtit në Gur të Zi”**.




Fig. 10 & 11. Kopshti dhe çerdhja e re ne qytetin e Shkodrës, “Njomzat”¹¹

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrugëve rurale është një nga prioritetet kryesore të qytetareve (*Prioritet nr 13 “Vijimi i investimeve dhe ndërhyrjeve që përmirësojnë infrastrukturën”*) në lidhje me këtë sipas Bashkisë Shkodër infrastruktura rrugore është një nga prioritetet e Bashkisë së Shkodrës prej 5 vitesh. Pavarësisht vonesave në procedurat e tenderimit si pasojë e pandemisë, tashmë ka nisur puna në disa projekte të planifikuara në buxhetin e vitit 2020.

¹¹ <https://www.facebook.com/bashkiashkodres/photos/a.2998316383607542/2998317396940774/?type=3>

Me një fond 6.2 milion lekë nga të ardhurat e Bashkisë Shkodër, ka nisur puna për sistemim-asfaltim të rrugëve të brendshme në fshatin Gomsiqe të Njësisë Administrative Velipojë. Ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e banorëve, në një zonë me densitet të lartë banorësh, të banesave dhe njësive të shërbimit. Projekti parashikon shtresa rrugore çakëll, stabilizant dhe asfalt në një sipërfaqe 1900 metër katror; struktura monolite betoni për kanalizime anësore 115 metër kub si dhe sinjalistikë rrugore horizontale dhe vertikale. Impakti i këtij projekti në jetën e banorëve por edhe të vizitorëve të ndryshëm, do të jetë i dukshëm në përmirësimin e lëvizshmërisë të njerëzve, mjeteve dhe mallrave.

Po punohet në Njësinë Administrative Postribë, ku janë identifikuar rrugët më problematike që kanë nevojë për ndërhyrje. Sipas planit të paracaktuar nga Bashkia e Shkodrës, do të shtrohen me asfalt 400 metër katror në rrugën Mes- Meselim, 200 metër katror në rrugën e Rasekut, 100 metër katror në rrugën Mes- Kullaj dhe 150 metër katror në rrugën Boks- Ura e Rasekut.

Bashkia e Shkodrës ka përfunduar procesin e riparimit dhe mirëmbajtjes në rrugën "Lavdia" në Njësinë Administrative Rrethina.



Fig. 12&13. Rikonsruksioni i rrugeve rurale ¹²

¹²https://www.facebook.com/bashkiashkodres/photos/ms.c.eJxFzsENwDAIQ9GNKiBgzP6LVQWVXJ~_Cf6wIElUnhJ~;rCESniFYwEBcsFLXNOV~;QmIA7sa8AO9Jb4T~_4P5liVqoga3EGZCFbAhsJfr51ZmIDskDlbtBdzZMT8~- .bps.a.2986885474750633/2986886098083904/

Këshilli Bashkiak Shkodër ka fokusuar punën e vet në konsolidimin e instrumentave të monitorimit dhe rregullimit të brëndshëm, procese të cilat do të përmirësojnë jo vetëm punën brënda organeve të këshillit por edhe në raport me shërbimet që ofron në tërësi Bashkia Shkodër. Këshilli Bashkiak në punën e saj është fokusuar gjatë 3 mujorit të parë të 2020 në:

Përditësimin e Rregullores së Brëndshme të KB

Detajimin e Planeve të Punës së KB dhe Komisioneve të Përhershme të tij

Vënien në zbatim të Planeve të Monitorimit të shërbimeve të bashkisë.

Një nga problemet dhe gjithashtu kërkesat e kontratës sociale 2015, në lidhje me **Kartën e Studentit** tashmë është realizuar dhe anëtarët e Keshillit Bashkiak edhe në diskutimet në mbledhjet e zhvilluara kanë shprehur angazhimin për të përfshirë sa më shumë shërbime dhe lehtësi për përdoruesit e saj.

Plani Lokal i veprimit për rininë edhe ky një nga pikat e kontratës sociale 2015 vazhdon të jetë një premtim i pambajtur por nga komunikimi me zyrtarë të Bashkisë Shkodër na është komunikuar se po Krijohet një plan veprimi i cili ka marrë në konsideratë Draft-Planin e Veprimit për Rininë të hartuar nga Shoqata “Intelektualet e Rinj, Shprese” dhe gjatë vitit 2020 do të nisë edhe puna për konsultimin më sa më shumë grupe interesi ndër ta edhe Shoqata jonë.

Gjatë takimeve me qytetaret vazhdimisht janë adresuar probleme sociale, si papunësia, mundësitë e pakta ekonomike, diferencimi fshat/qytet etj, pabarazia mes detyrimeve fiskale dhe shërbimeve që marrin qytetaret. Në paketën Fiskale 2020 të miratuar tashmë ka shumë me teper lehtësi dhe përjashtime nga pagimi i tarifave të ndryshme për kategorite dhe grupet në nevojë dhe është cilësuar si paketa fiskale më sociale.

Këshilli Bashkiak miratoi Paketën e re Fiskale për Bashkinë Shkodër. Përafrimi me politikat e majta me qëllim lehtësimin nga tarifat të shtresave në nevojë apo rritjen e shtrëngimeve ndaj atyre që ndosin, bllokojnë etj.ishin risi që e bëjnë paketën fiskale më sociale të apikuar ndonjëherë në Bashkinë Shkodër. Nga data 1 janar 2020:

- 0 tarifë në sistemin arsimor parashkollor për fëmijët e familjeve me prind PAK, familje me Ndihmë Ekonomike apo për fëmijët e k/familjareve të veja apo nënave me urdhër mbrojtje.
- Kush ndot më shumë, paguan më shumë: diferencohet taksa e pastrimit sipas llojit të biznesit.
- Diferencim i tarifës së ndriçimit sipas dendësisë së popullsisë dhe fluksit të vizitorëve.
- Akses në qytet për personat me AK: gjobë për bllokim të rampave të trotuareve apo të vendparkimeve të dedikuara për këtë grup (Të ardhurat nga këto zëra shkojnë në mbështetje direkte të kësaj kategorie në nevojë)
- Tarifim maksimal për zënien e hapsirës publike.
- Akses i shtuar për studentët, fillon implementimin Karta e Studentit

Ngritja e një Qendre Multifunkionale Rinor është krijuar dhe funksionon tashmë Qendra Rinore Publike “Po të Ardhmes” Atelie, dhe në Bashkepunim me qendren po punohet për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit.

Krijimi i bizneseve inkubatore për rininë ky është një pikë e kontartës që nuk është realizuar dhe nga komunikimet me Bashkinë Shkodër, mungesa e fondeve për realizimin e kësaj pike deklarohet se është shkak për mosrealizimin. Pranë Qendres Rinore Publike ka disa ambjente që i janë dedikuar bizneseve inkubatore por aktualisht janë jo funksionale sepse kërkohen fonde.

Krijimi i programeve të specializuara për trajtimin e problemeve sociale të të rinjve – ne lidhje me kete pike në Bashkinë Shkodër janë ngritur qendra komunitare që ofrojnë shërbime psikosociale për personat në nevojë por nuk kanë të targetuara në mënyrë të veçantë të rinjtë.

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit online – në lidhje me këtë në bashkinë Shkodër është ngritur një platforme online dedikuar të rinjve dhe administrohet nga Qendra Publike Atelie.¹³

¹³ Shih linkun <https://shkodrarinore.gov.al/>

Nga takimet me qytetaret dhe intervistat e strukturuar rezultojn:

- 66% e të intervistuarve vleresojnë punën e Bashkisë Shkodër.
- 70% e personave nga zonat rurale mendojnë se investimet ne zonat rurale janë minimale. Keto investime kryesisht janë në mirëmbajtjen e rrugëve dhe pastrimin e disa kanaleve kulluese.
- 71% mendojnë se nuk ka programe për të rinjtë me synim punësimin apo mbështetjen me programeve të specializuara për mbështetje financiare për startup-et rinore nga Bashkia Shkodër.
- 65% mendojnë se në lidhje me programet për zhvillimin e grave dhe vajzave Bashkia Shkodër ka zhvilluar programe psikosociale për rastet e dhunës në familje por mungojnë programe për rritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave në mënyrë që të pregatiten për tregun e punës, kjo sidomos në zonat rurale.
- 72% e të intervistuarve kërkojnë që ndihma financiare të jetë më e madhe.
- 59% e të intervistuarve kërkojnë lehtësim të taksave dhe pagesave të ujit dhe dritave sepse për shkak të pandemise botërore të ardhurat e tyre janë zvogëluar.
- 70% nuk kanë informacion në lidhje me mbledhjet e Këshillit Bashkiak.



Rekomandime

- Procesi i konsultimit për shkak edhe të pandemisë nuk është zhvilluar në mënyrën e duhur.
- Nevojitet më tepër bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse dhe grupet e interesit për të zhvilluar një proces efektiv konsultimi.
- Këshilli Bashkiak mund të realizojë marrëveshje ose memorandume bashkëpunimi me organizata dhe grupe interesi për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje duke bërë procese efektive konsultimi.
- Në kushtet e Pandemisë Globale nevojitet të zhvillohen mjetet e komunikimit elektronik aplikacione mobile, blog, rrjete sociale, komunikime online, video konferenca etj ku qytetarët kanë lehtësi akses.
- Këshilli Bashkiak ka miratuar disa lehtësi fiskale dhe nevojitet më tepër informacion për përfituesit në lidhje me lehtësitë e ofruara.





Referenca:

- 1 <https://popnetwork.al/en/raporti-i-monitorimit-bashkia-shkoder-2/>
- 2 https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=710467076177360&id=231773114046761
- 3 <https://www.facebook.com/Keshilli-Bashkiak-Shkoder-110426817043979/>
- 4 http://irsh.al/ep-content/uploads/2020/05/Raporti_Bashkia-Shkoder_COVID-19.pdf
5. Njoftim_per_keshillim_me_publikun_Per_draftin_e_Projektplanit_Buxhetor_Afatmesem_2021_2023_te_Bashkis_e_Shkoder_1683_1
6. <https://www.facebook.com/bashkiashkodres/photos/a.426398424132697/3005515556220958/>
7. <https://www.facebook.com/370972339675306/posts/2839744762798039/>
8. <https://www.facebook.com/370972339675306/posts/2715019558603894/>
9. https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=710467076177360&id=231773114046761
10. <https://www.facebook.com/370972339675306/posts/2896711820434666/>
11. <https://www.facebook.com/bashkiashkodres/photos/a.2998316383607542/2998317396940774/?type=3>
12. <https://www.facebook.com/bashkiashkodres/photos/ms.c.eJxFzsENwDAIQ9GNKiBgZP6LVQWVXJ~Cf6wIEIUUnhJ~rCESniFYwEBcsFLXNOV~;QmIA7sa8AO9Jb4T~4P5liVqoga3EGZCFbAhsJfrr51ZmIDskdltBdzZMT8~-bps.a.2986885474750633/2986886098083904/>
13. <https://shkodrarinore.gov.al/>

Kontrata Sociale Shkoder: <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-shkoder/>

